

MËNYRA E VEPRIMIT GJATË PRISHJES SË SIGURISË TË INFORMATAVE TË KLASIFIKUARA

Hyrje

Në këtë dokument, Drejtoria për siguri të Informatave të klasifikuara (këtu e tutje: Drejtoria) shpjegon më hollësisht se si të veprohet në rast të shkeljes së sigurisë të Informatave të klasifikuara nacionale dhe të Informatave të klasifikuara të një shteti të huaj apo organizate ndërkombëtare.

Procedura është përcaktuar në përputhje me rregulloret nacionale mbi mbrojtjen e Informatave të klasifikuara dhe rregullat dhe praktikrat e pranuar ndërkombëtare për menaxhimin me Informatat e klasifikuara¹.

1. Raportimi dhe përcaktimi i shkallës së prishjes së sigurisë

Të gjitha prishjet e sigurisë së informatave të klasifikuara raportohen me shkrim, duke mos u vonuar, deri te oficeri i sigurisë në organin që është përgjegjës për mbrojtjen e atyre Informatave.

Funksionari i cili udhëheq me organin përgjegjës për mbrojtjen e informatave të klasifikuara njoftohet menjëherë nga oficeri i sigurimit për çdo prishjen e sigurisë të informatës së klasifikuar. Pas njoftimit, funksionari vendos mbi nevojën për të ndër marrë veprime për të përcaktuar shkallën e shkeljes së sigurisë së informatës së klasifikuara dhe për zbulimin ose publikimin e saj të mundshëm, të paautorizuar .

Përcaktimi i shkallës së shkeljes së sigurisë të informatës së klasifikuar, kryhet nga ekspertë me përvojë profesionale të sigurisë dhe hetimit, të cilët janë të pavarur nga personat që lidhen drejtpërdrejt me shkeljen e sigurisë së informatës së klasifikuar.

2. Shkelja e sigurisë së informatës së klasifikuar pa pasoja të dëmshme

Nëse gjatë përcaktimit të shkallës së shkeljes të sigurisë, të informatës së klasifikuar, vërtetohet se shkelja e sigurisë së informatës së klasifikuar nuk ka shkaktuar pasoja të dëmshme, funksionari përgjegjës i organit përgjegjës për mbrojtjen e asaj informate mund të vendosë që të ndalojë vërtetimin e mëtejshëm të shkeljes së sigurisë të informatës së klasifikuar.

¹ Ligji për informata të klasifikuara (*) ("Gazeta zyrtare e RSM", nr. 275/19); C-M(2002)49-REV1; AC/35-D/2002-REV5; Vendimi i Këshillit i 23 shtatorit 2013 për rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informatave të klasifikuara të BE-së (Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian L 274/1).

Nëse gjatë përcaktimin të shkallës së shkeljes së sigurisë të informatës së klasifikuar të një shteti të huaj ose organizate ndërkombëtare, vërtetohet se shkelja e sigurisë së informatës nuk ka shkaktuar pasoja të dëmshme, funksionari përgjegjës i autoritetit përgjegjës për mbrojtjen e këtyre informatave në konsultimi paraprak me Drejtorinë, mund të vendosë të ndalojë përcaktimin e mëtejshëm të shkeljes së sigurisë të asaj informate, edhe pa njoftim me shkrim, për të ndalimin e mëtejshëm, deri te autoriteti i huaj, përgjegjës për mbrojtjen e informatës së klasifikuar, siguria e të cilës është kompromentuar.

3. Njoftimi i krijuesit të Informatës së klasifikuar

Për shkeljen e sigurisë të informatës së klasifikuar i raportohet njëkohësisht krijuesit të informatës. Nëse ai nuk dihet, ose nëse është e vështirë të identifikohet, detyrimi për ta raportuar atë transferohet tek zyrtari që administron autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e informatës së klasifikuar siguria e të cilit është kompromentuar, pra Drejtoria.

Për shkeljen e sigurisë së informatës së klasifikuar të një shteti të huaj ose organizate ndërkombëtare duhet të njoftohet Drejtoria, dhe nëpërmjet saj edhe autoriteti i huaj ose ndërkombëtar përgjegjës për mbrojtjen e këtyre informatave të klasifikuara.

4. Raporti i parë i shkeljes së sigurisë të informatës së klasifikuar

Raporti i parë mbi shkeljen e sigurisë së informatës të klasifikuar jep informatë mbi:

- llojin dhe formën e informatës, shkallën e klasifikimit të saj, emrin e autoritetit që krijoi informatën, numrin e rastit dhe datën, emërtimin dhe numrin e kopjes, lëndën me të cilën lidhet dhe fushëveprimin;
- një përshkrim të shkurtër të rrethanave në të cilat ka ndodhur shkelja e sigurisë, datën e shkeljes së sigurisë, periudhën gjatë së cilës informata ishte i ekspozuar ndaj zbulimit dhe, nëse dihet, numri dhe/ose kategoria e personave të paautorizuar që kishin ose mund të kishin pasur qasje në informatën e klasifikuar, dhe
- a është i informuar krijuesi i asaj informate për shkeljen e sigurisë.

Raporte të tjera dërgohen sipas dinamikës që ndjek zhvillimin e ngjarjeve, duke marrë parasysh ndjeshmërinë e informatës, siguria e së cilës është kompromentuar dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja.

5. Raporti përfundimtar mbi shkeljen e sigurisë së informatës së klasifikuar

Raporti përfundimtar mbi shkeljen e sigurisë së informatës së klasifikuar i dorëzohet funksionarit përgjegjës për mbrojtjen e informatës së klasifikuar, siguria e të cilës është kompromentuar, pra pranë Drejtorisë dhe nëpërmjet saj, autoritetit të huaj ose ndërkombëtar përgjegjës për mbrojtjen e këtyre informatave të klasifikuara, jo më vonë se 90 ditë nga paraqitja e raportit të parë.

6. Raporti mbi vlerësimin e llojit dhe lartësisë së dëmit dhe mbi veprimet dhe masat e marra për zbutjen ose zvogëlimin e tij.

Raporti i krijuesit të informatës së klasifikuar për zbulimin e paautorizuar dhe shkeljen e sigurisë të saj, është përgatitur në mënyrë që t'i mundësojë krijuesit të vlerësojë dëmin e shkaktuar dhe të ndër marrë veprimet e nevojshme ose të zakonshme për të zbutur efektet e dëmit.

Raporti mbi vlerësimin e llojit dhe lartësisë së dëmit dhe mbi veprimet dhe masat e marra për zbutjen ose zvogëlimin e tij i dorëzohet funksionarit përgjegjës të autoritetit përgjegjës për mbrojtjen e informatës së klasifikuar, siguria e së cilës është kompromentuar, pra pranë Drejtorisë dhe, nëpërmjet saj, autoritetit të huaj ose ndërkombëtar përgjegjës për mbrojtjen e këtyre informatave të klasifikuara.

7. Mbajtja e evidencës

Oficeri i sigurimit i autoritetit përgjegjës për mbrojtjen e informatës së klasifikuar, siguria e së cilës është komprometuar, është i detyruar që të mbaj evidencë për rastet e qasjes së paautorizuar apo komprometimin e informatës të klasifikuar dhe të veprimeve të ndërmarra dhe të njoftojë menjëherë Drejtorinë për këtë rast dhe veprim.

u.d. Drejtori

Stojan Slaveski

² Në bazë të nenit 68,1(8) të Ligjit për informatat e klasifikuara (*)